



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:250582

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05703676

KE.nr.233/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen kontestimore të paditësit OJQ “Vita Kosova” me seli në Prishtinë, me pronar G.A. nga Presheva, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Nita Xhema Hoti avokate dhe Nexherije Hoti Avokate me seli në Prishtinë Rr.”Tringë Smajli” kati I-rë, banesa nr.4, kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Recreacionit dhe Sportit me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Nazmije Aliu, me objekt kontesti kthimi i borxhit dhe shpërblimi i dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, më datën 30.04.2024, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, ndërsa me datën 17.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, OJQ “Vita Kosova” me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet i padituri Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Recreacionit dhe Sportit me seli në Prishtinë, t’ia paguaj në emër të borxhin të mbetur shumë prej 9,390.00 për vitin 2010, dhe shumë prej 20,000.00 për vitin 2011, në shumë të përgjithshme prej 29,390.00 euro, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 25.10.2011, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë me të cilën ka kërkuar ti paguhet në emër të borxhit në shumë prej 640.00 euro për vitin 2010, si dhe kompensimi i dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës dhe atë shumë prej 20,000.00 euro për vitin 2011 dhe shumë prej 40,000.00 euro për vitin 2012.

- III. DETYROHET pala e paditur që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 4,232.40 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Paditësi OJQ “Vita Kosova” me seli në Prishtinë, përmes të autorizuarës më datën 25.10.2011 pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë ka paraqitur padi për pagesën e borxhit të mbetur të pa paguar në bazë të kontratës të datës 30.01.2010, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata t'ia paguaj shumën prej 90,000.00 euro, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste nga dita e parashtrimit të padisë datë 25.10.2011, e deri në pagesën definitive, njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Pala paditëse pretendon se me datë 30.01.2010, ka nënshkruar marrëveshje me të paditurin, nga e cila marrëveshje rrjedhin detyrime për të dyja palët kontraktuese, e ku paditësi merr detyrim që në territorin e Republikës së Kosovës ti formoj katër qendra në Prishtinë, Gjilan, Graçanicë dhe Mitrovicë me qëllim të implementimit të projektit “Dëgjo Rininë” në kohëzgjatje prej 3 vitesh (2010, 2011, 2012) deri sa e paditura merr në detyrim financimin e këtij projekti në shumë prej 40,000.00 euro për çdo vit kalendarik. Më tej ka shtuar se pala paditëse ka përmbushur në tërësi pretendimet e saja kontraktuese, deri sa pala e paditur vetëm pjesërisht nga shuma e tërësishme duke paguar shumën prej 30,000.00 euro në vitin 2012, ndërsa detyrimet tjera nuk i ka përmbushur. Me parashtresën e datës 09.07.2019, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe atë në emër të kompensimit të dëmit gjegjësisht t'ia paguaj borxhin e mbetur të pa paguar në shumë prej 90,000.00 euro dhe atë në bazë të marrëveshjes për partneritet e datës 30.01.2010, lidhur me projektin “Dëgjo Rininë” dhe atë për vitin 2010 borxhin e mbetur prej 10,000.00 euro, për vitin 2011 borxhin e mbetur në shumë prej 40,000.00 euro dhe për vitin 2012 borxhin e mbetur prej 40,000.00 euro, për shkak të mos përmbushjes së marrëveshjes dhe shpërbërjes së njëanshme të marrëveshjes nga i padituri.

Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin III.EK.nr.464/17 të datës 12.03.2021, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit OJQ “Vita Kosova” kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Kulturës, Rekreacionit dhe Sportit me seli në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë duke vendosur sipas ankesave të palëve në procedurë, me aktvendim K.DH.SH.II.nr.845/2022 të datës 09.03.2023, ka aprovuar ankesat e palëve ndërgjyqëse, ndërsa Aktgjykimin III.EK.nr.464/2017 të datës 12.03.2021, të Gjykatës së shkallës së parë, e ka prishur dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditësit, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë, përmes së cilës është bërë rregullimi padisë në aspektin subjektiv në drejtim të paditurit, është saktësuar kërkesa sa i përket ekzistimit të raportit detyrimor, është dëshmuar aktiviteti i punës të punëtorëve të paditësit, është përcaktuar baza juridike e kërkesëpadisë si dhe është saktësuar lartësia e kërkesëpadisë sa i përket detyrimit kryesor dhe kamatës. Pos tjerash ka theksuar se gjatë procedurës gjyqësore ka bashkangjitur të gjitha provat lidhur me mbarëvajtjen e aktiviteteve, raportet e punës, kontratat e punëtorëve që kanë punuar në qendrën në Prishtinë, Gjilan, Graçanicë, Mitrovicë dhe provat e tjera për punën e kryer të punëtorëve. Ka shtuar se Qendra në Prizren për shkak të rrethanave të paraqitura që nga fillimi nuk ka funksionuar për shkaqe objektive që kanë ekzistuar në kohën e hapjes. Më tutje ka theksuar se nuk qëndron pretendimi i të paditurit se paditësit i është dërguar Njoftimi mbi ndërprerjen e kontratës të datës 27.06.2011, nga i padituri, dhe se i padituri nuk ka marrë asnjë veprim për ndërprerjen e kontratës pas vendimit të Komunës së Gjilanit të datës 24.05.2011, mbi pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve të OJQ-së, e pas këtij vendimi menaxheri dhe punëtorët kanë vazhduar punën dhe aktivitetet në këtë organizatë. Nga arsyet e lartcekura i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit me kërkesën si në precizimin e lartcekur.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka precizuar.

I autorizuari i të paditurit përmes përgjigjes në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar për shkak se i padituri pas vlerësimit të projektit e në veçanti duke u bazuar në parregullsi ka vendos që këtij projekti të mos i paguhet edhe pjesa tjetër e marrëveshjes pasi që me rastin e inspektimit në teren nuk kishte dëshmi se qendra në Prizren ishte hapur ndonjëherë, do të thotë se kurrë nuk është hapur edhe përkundër marrëveshjes që ka qenë e obliguar të hapet edhe një qendër në Prizren. Komuna e Gjilanit me vendim e kishte pezulluar aktivitetin e kësaj OJQ-je në Gjilan me arsyetimin se kishte pasur parregullsi në menaxhimin e financave, ndërsa në Prishtinë nuk kishte sjell raport për aktivitet e saj, nuk kishte lajmëruar- raportuar për rastin e vjedhjes së ndodhur në zyrat e kësaj qendre. Ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës u vërtetua edhe një herë se kontratat e punëtorëve nuk janë harmonizuar me formën e standardeve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale sipas Ligjit të Punës NR.03/L-212, punëtorët nuk janë lajmëruar në ATK e as në trustin Pensional të Kosovës, ka pas vonesa në pagesat e të ardhurave personale për stafin për disa muaj radhazi. Ka theksuar se nga arsyet e cekura më lartë, marrëveshja në mes të palëve kontraktuese ka përfunduar me njoftimin me numër 1329/2011 të datës 27.06.2011.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Certifikata e paditësit me numër 5101863-0, lëshuar nga UNMIK; Marrëveshja për partneritet e dt.30.01.2010, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit; Certifikata e regjistrimit të OJQ-ve, me numër 5101863-0, lëshuar nga Ministria e Administratës Publike; Plan programi i paditëses për qendrën në Gjilan për muajt gusht-dhjetor 2009; Evidenca e paditësit lidhur me vajtje- ardhjen e punëtorëve në punë; Kontratat e punës të punëtorëve që ishin angazhuar tek paditësi; Lista e pjesëmarrësve në promovimin ICCD; Përgjigje nga Drejtoria e Arsimit; Kërkesa për formimin e grupit të rinjëve e datës 18.02.2009; shkresa elektronike e datës 11.03.2010, në dy shtojca; Projekti në qendrën në Gjilan i datës 01.04.2010; interpretimi i datës 31.05.2011, nga paditësi; Urdhërpagesat e datave 07.04.2010, 09.06.2010, 21.06.2010 dhe datës 08.11.2011; Shkresë e lëshuar nga Ministria e Sportit e datës 24.06.2011; Vendimi nga Komuna e Gjilanit e datës 23.05.2011; Raporti zyrtar nga Agjencia e Inspektoratit me numër 010688 i datës 29.03.2011; Njoftimi për përfundimin e marrëveshjes me numër 1329/2011 i datës 27.06.2011; Ekspertiza financiare e punuar nga R.B. e datës 03.03.2020, së bashku me provat si dhe plotësimi i ekspertizës i datës 19.10.2020.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe gjeti se kërkesepadia e paditësit është pjesërishtë e bazuar dhe atë për shkaqet si në vijim:

Nga deklarimet e palëve ndërgjyqëse rezulton se për asnjërën palë nuk ishte kontestues fakti se palët kishin pasur raporte kontraktuale për periudhën 3 vjeçare, ku paditësi kishte për detyrim të hapte 5 pika në regjionin e Kosovës, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Graçanicë me qëllim të krijimit të shërbimeve falas, për pritjen, dëgjimin, informimin, këshillim dhe orientimin e të rinjëve në fushat e psikosociale të punësimit dhe karrierës juridike, ndërsa i padituri kishte për obligim që për vitin e parë 2010 të përmbush detyrimin prej 40.000,00 euro në dy këste, kësti i parë në fillim të vitit dhe kësti i dytë në fillim të pjesë së dytë të vitit, dhe në funde të vitit 2010 të shqyrtohet mundësia e vazhdimit të përkrahjes edhe për vitet tjera të paraparë.

Në rastin konkretë kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte çështja e shkëputjes së një anshme të kontratës në Qershor të vitit 2011 dhe mos vazhdimi i kontratës.

Nga leximi i Certifikatës së paditësit me numër 5101863-0, e lëshuar nga UNMIK, dhe i Certifikatës së regjistrimit të OJQ-ve, me numër 5101863-0, lëshuar nga Ministria e Administratës Publike gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka të regjistruar veprimtarinë në Kosovë si Organizatë Joqeveritare në Republikën e Kosovës me datë 06.02.2003.

Nga leximi i Marrëveshjes për partneritet e dt.30.01.2010, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit, gjykata ka vërtetuar faktin se marrëveshja ka për qëllim implementimin e projektit Dëgjo Rininë, ku edhe kanë paraparë të drejtat dhe detyrimet e tyre, paditësi ka marrë për obligim të formoj 5 qendra për implementimin e projektit dhe atë në Prishtinë, Gjilan, Graçanicë, Mitrovicë dhe Prizren, me kohëzgjatje prej 3 vitesh, nga 2010, 2011 dhe 2012, ndërsa i padituri ka marrë për obligim financimin e aktiviteteve prej 40,000.00 euro për vit kalendarik, shumë të cilën do ta paguaj në dy këste, kësti i parë në fillim të vitit dhe kësti i dytë në fillim të pjesës së dytë të vitit.

Nga leximi i Plan programit i paditëses për qendrën në Gjilan për muajt gusht-dhjetor 2009, gjykata ka vërtetuar faktin se Qendra “Dëgjo Rininë” ka përpiluar një raport gjashtë mujor të aktiviteteve të saja për regjionin e Gjilanit.

Nga leximi i Evidencave të paditësit lidhur me vajtje- ardhjen e punëtorëve në punë, gjykata ka vërtetuar faktin se punëtorët SH.D., XH.S., L.Z. dhe D.R. kanë bërë vajtje dhe ardhje në punë në qendrën e OJQ-së në Gjilan për periudhën nga data 01.04.2010 deri me datën 30.09.2010.

Nga kontratat e punës e lidhur në mes të paditësit si punëdhënës dhe punëmarrësit L.Z. e sistemuar për kryerjen e detyrave të punës këshilltare e punësimit dhe karrierës në qendër në Gjilan të cilat i referohen periudhës 01.06.2009- 02.01.2011, me vlefshmëri deri me datë 31.03.2011.

Nga kontratat e punës e lidhur në mes të paditësit si punëdhënës dhe punëmarrësit D.R. i sistemuar si Këshilltar juridik në qendër në Gjilan, të cilat i referohen periudhës 01.09.2009- 01.04.2011, me vlefshmëri deri me datë 31.04.2011.

Nga kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit si punëdhënës dhe punëmarrësit G.A. i sistemuar si drejtor në qendrën Dëgjo Rininë, me datë 01.01.2010 me kohëzgjatje deri me datë 31.12.2010.

Nga kontratat e punës e lidhur në mes të paditësit si punëdhënës dhe punëmarrësit XH.S. e sistemuar si këshilltare Psikosociale në Qendrën “Dëgjo Rinin” në Gjilan, të cilat i referohen periudhës 04.01.2010- 31.06.2010.

Nga kontratat e punës të lidhur në mes të paditësit si punëdhënës dhe punëmarrësve SH.D., F.J., N.K., D.I.G., A.K., K.H., M.M., A.B., , të njëjtit janë sistemuar në pozita të ndryshme për periudha të shkurtra nga dy dhe tre muaj brenda vitit 2010.

Nga leximi i Listës së pjesëmarrësve në promovimin ICCD, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka evidentuar 24 pjesëmarrës në promovim.

Nga leximi i kërkesës për formimin e grupit të rinjve e datës 18.02.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjilan për formimin e grupit të rinjve dhe intervenim nëpër shkolla.

Nga leximi i përgjigjes nga Drejtoria e Arsimit të Komunës së Gjilanit, gjykata ka vërtetuar faktin se e njëjta është pajtuar që paditësi në shkolla të realizoj aktivitetet për “Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve”, Shënimin e ditës kundër Duhanit, dhe Aktivitete për “Ditën Ndërkombëtare kundër Duhanit”.

Nga leximi i shkresave elektronike e datës 11.03.2010, në dy shtojca, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka komunikuar me SH.K.- nga Drejtoria e Arsimit në Gjilan për mbajtjen e aktiviteteve të ndryshme me nxënësit e shkollave të Komunës së Gjilanit.

Nga leximi i projektit në qendrën në Gjilan i datës 01.04.2010, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka përpiluar për projektin “Respektimi i të drejtave të Punëtorëve”, kohëzgjatja e projektit ishte një ditë dhe qëllimi i këtij projekti është mbështetja dhe respektimi i të drejtave të punëtorëve.

Nga leximi i interpretimit të datës 31.05.2011, nga paditësi, gjykata ka vërtetuar faktin se ka kërkuar interpretimin e “Marrëveshjes për partneritet” nga i padituri duke kërkuar validitetin e kësaj marrëveshje.

Nga leximi i Urdhërpagesave të datave 07.04.2010, 09.06.2010, 21.06.2010 dhe datës 08.11.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri ka kryer katër pagesa për të paditurin në shumë të përgjithshme prej 30,610.00 euro.

Nga leximi i raportit zyrtar nga Agjencia e Inspektoratit me numër 010688 të datës 29.03.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se ka kryer kontrollin inspektuese te paditësi dhe ka

përpiluar raportin pas kontrollimit të dokumentacionit dhe administrimit të provave relevante, ka konstatuar gjendjen faktike nga të gjeturat.

Nga leximi i Vendimit të Komunës së Gjilanit i datës 23.05.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se me këtë vendim është pezulluar aktiviteti i paditësit në qendrën Dëgjo Rininë në Gjilan.

Nga leximi i shkresës së lëshuar nga Ministria e Sportit e datës 24.06.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri ka përpiluar raportin e aktivitetit në qendër Dëgjo Rininë në Gjilan, ka marrë vendim që ti paguhen paditësit shuma prej 10,000.00 euro dhe të mbyll këtë projekt.

Nga leximi i njoftimit për përfundimin e marrëveshjes me numër 1329/2011 i datës 27.06.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri ka lëshuar njoftimin për përfundimin e marrëveshjes për partneritet të datës 30.01.2010, me paditësin, për arsye të mos përmbushjes së kushteve të përcaktuara në marrëveshje dhe shkeljeve të konstatuara gjatë periudhës që palët ishin në marrëveshje.

Nga ekspertiza financiare e punuar nga R.B. e datës 03.03.2020, së bashku me provat si dhe plotësimi i ekspertizës i datës 19.10.2020, është konstatuar fakti se paditësi dhe i padituri me datën 30.01.2010, kanë lidhur marrëveshje për partneritet në kohëzgjatje për tri vite, por duke mos e përjashtuar punën provuese e cila është protokolluar me nr.442/2010 me datë 03.03.2010, me të cilin MKRS është zotuar se do ta financojë projektin “Dëgjo Rininë”, për vitin 2010 në shumë prej 40,000.00 euro. Po ashtu eksperti ka konkluduar se qendra e OJQ-së “Vita e Kosovës” janë hapur dhe kanë funksionuar në këto qendra: Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan dhe Graçanicë, kurse në Prizren nuk ka funksionuar as një qendër, eksperti ka paraparë dy variante dhe atë borxhi dhe gjer në përfundim të aktiviteteve për vitin 2010 është në shumë prej 10,000.00 euro, ndërsa për periudhën Janar- Mars 2011 (periudhë e justifikuar me kontrata të punës të aktivistëve) shuma prej 10,000.00 euro gjithsej shuma prej 20,000.00 euro, kurse varianti i dytë është: borxhi gjer ne ndërprerjen (përfundimin) e marrëveshjes për vitin 2010 është në shumë prej 10,000.00 euro dhe për periudhën Janar- Qershor 2011 në shumë prej 20,000.00 euro gjithsej në shumë prej 30,000.00 euro, me kërkesë të palës paditëse eksperti ka bërë plotësimin e ekspertizës së datës 19.10.2020, si variant të tretë ku ka bërë edhe kalkulimin për periudhën tri vjeçare obligimi vjetor 40,000.00 euro, obligimi për tri vite (40,000.00 x3) në shumë prej 120,000.00 euro, kompensimi i paguar nga i padituri në shumë prej 30,000.00 euro sipas variantit të tretë obligimi i mbetur për pagesë gjerë në përfundim të afatit të kontratës arrin shumën prej 90,000.00 euro.

Në këtë çështje juridiko-kontestimore Gjykata gjeti zbatim në dispozitat ligjore të parapara në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) tutje LMD.

Sipas nenin 15 të LMD-së është përcaktuar se *“Në themelimin e kontratave dypalshe, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke”*, ndërsa me nenin 17 të LMD-së është përcaktuar se *”pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”*, andaj gjykata në bazë të këtyre dispozitave dhe gjendjes faktike ka vlerësuar se ekziston detyrimi i të paditurit për pagesën e borxhit në shumën e gjuar. Pasi që i padituri, duke mos e përmbushur detyrimin e tij, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën siç është përcaktuar në marrëveshjen e datës 30.01.2010, deri më datën e njoftimit për shkëputjen e një anshme të marrëveshjes.

Andaj në mes të palëve është krijuar raport detyrimor, në të cilin paditësi ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri cilësinë e debitorit. Po ashtu me nenin 262 paragrafi 1 të LMD-së është përcaktuar se *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e borxhit sipas marrëveshjes së lartcekur i ka mbetur borxh paditësit ta përmbush obligimin për vitin 2010 dhe gjysmën e vitit 2011, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që të detyroj të paditurin që paditësit t’ia paguaj borxhin në shumën e gjuar dhe atë për periudhë për të cilën nga provat e ofruara është vërtetuar se paditësi pjesërishtë i ka përmbushur obligimin e marrë sipas kontratës nga data 30.01.2010, duke ushtruar aktivitetin e saj obligim të marrë sipas marrëveshjes e deri me datën 27.06.2011, ku me njoftimin e të paditurit është përfunduar marrëveshja për partneritet, me arsytim se nuk janë përmbushur të gjitha pikat e marrëveshjes, gjegjësisht nuk është hapur pika në Prizren, nuk është sjellur dëshmia e policisë lidhur me paraqitjen e rastit të vjedhejs së datës 17.01.2011, por është sjellur dëshmia e me datën 17.06.2011 e cila mbante datën 17.05.2011, nuk ishte sjellur raporti i aktiviteteve në qendrën në Prishtinë.

Gjykata duke vepruar sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Dhomave të Shkallës së Dytë dhënë sipas Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.845/22 të datës 09.03.2023, duke e ftuar palën aktive në procedurë që të paraqes provat lidhur me aktivitetet në qendrat e përcaktuara në marrëveshje bazuar në detyrimet kontraktuale, dhe të konstatoj faktin se a ka pasur punëtor të angazhuar në këto qendra dhe a janë raportuar tek institucionet përkates.



Më tej sipas nenin 262 paragrafin 2 është përcaktuar se *“Kur debitori nuk e përmush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”*.

Gjykata ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë prej 60,000.00 euro, si të pa bazuar për arsye se, i padituri e ka njoftuar paditësin për ndërprerjen e marrëveshjes, ndërsa periudhat tjera nuk janë të provuara se paditësi ka ushtruar aktivitet, apo se i njëjti ka pësuar ndonjë dëmë nga ndërprerja e marrëveshjes nga ana e të paditurit, meqense paditësi nuk i ka përmbushur obligimet e tij sipas marrëveshjes dhe se për këtë arsye ka ardhur deri te ndërprerja e marrëveshjes së datës 30.01.2010. Rrjedhimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se pas datës së shkëputjes së marrëveshjes, paditësi me as një provë nuk ka vërtetuar se i njëjti ka pësuar dëmë materia.

Nga provat e administruara dhe vërtetimit të gjendjes faktike është konstatuar se paditësja ka sjellur vetëm raportin lidhur me aktivitetin në qendrën e sajë në Gjilan, ndërsa për qendra tjera nuk ka sjellur as një provë lidhur me aktivitete të zhvilluara, ndërsa nga kontratat e punës përmes të cilëve ka angazhuar sataf mbështetës për zhvillimin e projektit sipas marrëveshjes me të paditurën, me as një provë nuk është vërtetuar se këta punëtor ishin të paraqitur pranë organeve kompetnete si të punësuar tek paditësja, me as një provë nuk është dëshuar mënyra e pagesës së pagës të punësuarve dhe se kontratat e punës ishin të gjitha me kohë të caktuar periudhë kohore dy – tre mujore efektivishtë disa ishin deri më datën 31.04.2011.

Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit, në rastin konkret nuk është provuar me asnjë provë që e paditura me shkëputjen e një anshme të marrëveshjes ka shkaktuar ndonjë dëm ndaj paditëses. Në shkresat e lëndës nuk ka prova që vërtetojnë përgjegjësinë juridike të paditurit me të cilën do të vërtetohej veprimi i kundërligjshëm i të paditurit apo shkaktim i ndonjë dëmi.

Gjykata sqaron se me nenin 7.1. lidhur me Nenin 319 dhe 322 të LPK-së palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre, të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla dhe barra e të provuarit të fakteve në të cilat pala i bazon pretendimet e tyre bie mbi atë palë. Andaj, me faktin se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën vërtetohet përgjegjësia civile-juridike e të paditurit për shkëputjen e marrëveshjes dhe më pas për shkaktimin e dëmit, gjykata erdhi në përfundim se nuk plotësohen kushtet ligjore për shpërblimin e dëmit sipas dispozitës së nenit 262 paragrafin 2 të LMD-së dhe kërkesëpadia e paditësit u refuzua si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa kërkesën në shumë prej 610.00 euro në emër të borxhit për vitin 2010, gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar, për faktin se nga provat e dorëzuara nga i padituri konkretisht urdhërpagesat e datave 07.04.2010, 09.06.2010, 21.06.2010 dhe datës 08.11.2010, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri ka kryer katër pagesa për të paditurin në shumë prej 30,610.00 euro, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të provave të dorëzuara nga palët ne procedurë.

Gjykata ka vlerësuar theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në marrjen ndryshe të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke iu referuar nenit 277 të LMD-së (1978) i aplikueshëm për detyrimet që kanë lindur para datës 20.12.2012, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar për pjesën aprovuese të kërkesë padis, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit të dëmit paditësit t'ia paguajë edhe kamatën ligjore si për mjetet e deponuara në bankat komerciale në periudhë kohore prej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 25.10.2011, datë e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i palës së paditur, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi, dhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208.00 euro, në emër të taksës për padi shumë prej 450.00 euro, në emër të përpilimit të ekspertizës shumë prej 500 euro, në emër të përfaqësimit në njëmbëdhjetë seanca (11x270.40 euro) shumë prej 2,974.40 euro në shumë e përgjithshme prej 4,232.40 euro.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.233/23, datë 17.05.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.